

VENDIM
Nr.64, datë 13.6.2008

**MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË “ERS-08” SHPK PËR LICENCIMIN NË
AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË
CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA PARKU EOLIK LEZHË**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pikat 1 germa “a”, dhe 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, pika 1 dhe 2, si dhe 14, të Rregullores për procedurat e licencimit”, miratuar me vendimin nr.24, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERS-08” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parku eolik Lezhë, konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.29, datë 4.3.2008.
2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku eolik, shoqëria “ERS- 08” sh.p.k. në aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë pronësinë e aseteve për zonën ku shtrihet parku eolik Lezhë, duke mos plotësuar nenin 9 pika 2 germa “e” të “Rregullores për procedurat e licencimit”, një nga kushtet bazë për ushtrimin e aktivitetit që kërkohet të licencohet.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e licencimit të shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik Lezhë.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta